

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në kapitullin e ardhshëm, do të studiojmë raportet dhe përpjesëtimet. Për të kuptuar konceptin e raporteve, do të nisemi nga shembulli i përzierjes së bojrave me përqindje të ndryshme. Ky model do të na ndihmojë që ta kuptojmë më me lehtësi idenë e raportit dhe të përpjesëtimit. Për shembull, Përzierja A do të ketë ngjyrë më të errët sepse raporti i bojës me ujin është 3:1, ndërsa në Përzierjen B vetëm 2:1.



Do të mësojmë edhe si t'i përpjesëtojmë raportet. Për shembull, për të përgatitur një sasi më të madhe të Përzierjes A, duhet ta mbajmë raportin të pandryshuar, duke shtuar numrin e kutive. Kjo mund të arrihet duke i shumëzuar të dy skajet e raportit me të njëjtin numër.

Edhe përqindjet janë një lloj raporti. Disa njerëz mund të përdorin shprehjen “4 çdo 5 atletë”, ndërsa të tjerë mund ta përshkruajnë të njëjtin grup si “80% e atletëve”. Shpesh nuk na intereson të dimë për madhësinë e saktë të dy palëve, por vetëm duam të marrim vesh se ç'përqindje të së tërës përfaqëson secila palë. Mund të sillni shembuj situatash ku keni parë të përdoren përqindje?

Përpjesëtimet do t'i përdorim për të gjetur madhësi që nuk i dimë dhe për të marrë me mend madhësi të tilla që do ta kishim të vështirë, në mos të pamundur, t'i numëronim. Për shembull, mund të marrim me mend përafërsisht numrin e përgjithshëm të njerëzve të prekur nga një epidemi gripi, duke numëruar sa tillë ka në një mostër të vogël dhe pastaj duke e përdorur përpjesëtimin për të arritur në një rezultat total të përafërt.

Fjalor Dy terma të rinj që do të ndeshni këtë kapitull:

përpjesëtim

tarifë për njësi

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Nxiteni fëmijën t'ju sjellë shembuj të ndryshëm të përdorimit të raporteve në jetën e përditshme, si për shembull, kur duhet gjetur kostoja e 5 kutive të konservave kur dimë që 2 kuti kushtojnë 70 cent. Shembuj të tjerë mund të jenë raporti i të rriturve me të miturit në një ekskursion, ose një etiketë që informon se pija juaj e preferuar përmban 10% lëng frutash.